

**ARDIAN MUHAJ**

## **SKLLAVËRIA NDËR SHQIPTARË GJATË MESJETËS**

Skllavëria, dhe dilemat që ky fenomen social u ka paraqitur shoqërive njerëzore, shkon shumë kohë më herët se sa periudha e kolonializmit evropian dhe skllavërimi i zezakëve afrikanë. Sipas C. Meillassoux, skllavëria përbën një periudhë të historisë botërore që ka prekur të gjithë kontinentet, ndonjëherë në të njëjtën kohë, apo në periudha të ndryshme.<sup>1</sup> Megjithëse skllavëria është një dukuri e përbotshme dhe që po gjen një trajtim gjithnjë e më të thellë në studimet historike, është një çështje e patrajtuar mirëfilli nga autorët shqiptarë. Autorë të huaj e kanë përfshirë dukurinë e skllavërisë në trojet shqiptare gjatë mesjetës në trajtesat më të gjera në kuadër të historisë së migrimeve ndërmjet dy brigjeve të Adriatikut.<sup>2</sup>

Kanë ekzistuar veçori të ndryshme të dallimit dhe inferioritetit që kanë qëndruar në themel të fenomenit. Të tilla veçori kanë qenë raca, etnia, kultura, feja, faji (kriminalizimi) etj. Burimet kryesore të skllavërisë kanë qenë padyshim luftërat dhe pirateria, por edhe skllavërimi për borxhe ka pasur një shtrirje të gjerë. Një veçori që mund të konsiderohet si e përgjithshme dhe e përhershme, është se imponuesit e skllavërisë në shoqëritë e ndryshme i kanë perceptuar viktimat e tyre si pjesë jopërbërëse e shoqërisë dhe si inferiorë. O. Patterson, këtë gjendje e ka cilësuar si “vdekje sociale” të skllavit.<sup>3</sup> Në Athinën klasike skllavërimi

<sup>1</sup> Claude Meillassoux, *Anthropologie de l'esclavage. Le ventre de fer et d'argent*, Paris: Presses Universitaires de France, 1986, f. 20.

<sup>2</sup> Trajtohet shkarazi në kuadër të historisë së migrimit në përmbledhjen *Italia felix. Migrazioni slave e albanesi in Occidente. Romagna, Marche, Abruzzi secoli XIV-XVI*, bot. Sergio Anselmi. Ancona: Tecnostampa, 1988; Alain Ducellier, Bernard Doumerc, Brühilde Imhaus, Jean de Miceli, *Les Chemins de l'exil Bouleversements de l'Est européen et migrations vers l'ouest à la fin du Moyen*, Paris: Armand Colin, 1991; *Oriente e Occidente tra Medioevo ed Età Moderna: studi in onore di Geo Pistarino*, a cura di Laura Balletto, Genova: Brigati, 1997.

<sup>3</sup> Orlando Patterson, *Slavery and Social Death. A Comparative Study*, Harvard University Press, 1985, f. 3-9. Koncepti i vdekjes shoqërore është shtjelluar edhe nga sociologë si Zygmunt Bauman. Kjo shihet si gjendja e njerëzve të cilët nga shoqëria

i grekëve nuk shihej si diçka e pranueshme. Në të kundërtën, konsiderohej diçka normale që ata të ishin pronarë të skllavërve «barbaroi».<sup>4</sup>

Nga ana tjetër, duke folur rreth vendit të skllavërisë në strukturën sociale, D. Turley i ndan shoqëritë në të cilat ka ekzistuar ky fenomen, në: *shoqëri me skllavër*, dhe *shoqëri skllavërie*. Dallimi mes tyre qëndron në faktin që në rastin e parë ekzistenca e fenomenit është e kufizuar. Rrugët e furnizimit me skllavër dhe mbajtja e tyre ishin në një shkallë të tillë të vogël sa që zakonisht ishin informale, duke mos pasur nevojë për një sistem të organizuar. Ndërsa në rastin e dytë, liria e grupit dominues në shoqëri varet nga kontrollimi dhe zotërimi i të mirave materiale të krijuara nga skllavërit.<sup>5</sup>

### Çështje të terminologjisë

Mënyrat e ndryshme të shfrytëzimit të punës së detyrueshme përgjatë historisë njerëzore kanë sjellë edhe problemin e përkufizimit sa më të saktë të skllavërisë. Simbas Konventës së Skllavërisë së Lidhjes së Kombeve, të vitit 1926, e cila është ratifikuar edhe nga shteti shqiptar në vitin 1957, skllavëria përkufizohet si: statusi ose gjendja e një personi mbi të cilin ushtrohen ndonjë ose të gjitha të drejtat e pronësisë.<sup>6</sup>

Në mesin e studiuesve qofshin këta historianë, antropologë apo sociologë çështja e përcaktimit të termave të ndryshëm të përdorur gjatë historisë për të emërtuar skllavërinë natyrisht ka ngjallur diskutime. Meillassoux, mendon se të dhënat që disponojmë për shoqëritë antike nuk na garantojnë asnjë kriter që të mundemi të bëjmë një dallim të qartë mes skllavërve dhe të gjitha shtresave të tjera përbërëse të këtyre shoqërive.<sup>7</sup> Si mall që shitet, skllavi është thjesht pasuri që i përket

nuk janë të pranuar plotësisht si njerëz. Ideja që skllavëria ishte e barazvlefshme me vdekjen është disi më e lashtë dhe gjendet shpesh në shkrimet e Ulpianit, por edhe në idenë e stërlashtë se fitorja e një lufte i jepte të drejtën fitimtarit që të merrte vendimin për ta skllavëruar të mundurin në vend që ta vriste.

<sup>4</sup> David Turley, *Slavery*, Oxford: Blackwell Publishers, 2000, f. 2.

<sup>5</sup> *Po aty*, f. 4-5.

<sup>6</sup> Ndërsa tregtia e skllavërve si koncept përfshin të gjitha veprimet që çojnë në kapjen, blerjen ose shitjen e një personi me qëllim skllavërimin e tij. League of Nations, *Treaty Series Publication of Treaties and International Engagements registered with the Secretariat of the League of Nations*, volume LX, 1927, no. 1414, f. 263, article 1/a, 1/b.

<sup>7</sup> *L'esclavage en Afrique précoloniale*, ed. Meillassoux, Maspero: 1975, f. 20.

dikujt. Fakti që është njëkohësisht edhe njeri nuk shkon kundër këtij kuptimi. Thjesht, skllavi është mall i një natyre të veçantë, apo siç e quan Aristoteli “një lloj malli i gjallë”.<sup>8</sup> Skllavi si pasojë e statusit të tij, humbet tërësisht kontrollin jo vetëm mbi punën, por edhe mbi personin e tij. Thelbi i statusit të skllavit qëndron në atë se është pikërisht vetë skllavi që konsiderohet në të gjitha aspektet si një plaçkë që shitet, dhe jo thjesht puna apo krahu i punës së tij.

Në lidhje me origjinën e fjalës *skllav*, Ch. Verlinden thekson se fjala *sclavus* ka marrë për herë të parë domethënien juridike të skllavit në Gjermani rreth shek. X-XI. Termi u përdor ndaj paganëve sllavë të kapur në numër shumë të madh gjatë fushatave të ndërmarra në shek. X nga mbretërit saksonë.<sup>9</sup> Në shek. XIII si pasojë e rigjallërimit të trafikut të skllavëve ballkanikë drejt Italisë emri sllav shkon duke e humbur domethënien etnike, duke marrë kështu domethënien e fjalës latine *servus*. Pra, ka një përkim të qartë ndërmjet historisë së trafikut të skllavëve sllavë dhe asaj të fjalës *sclavus*= skllav.<sup>10</sup> Kështu shpjegohet edhe mungesa e përdorimit të emrit *sclavus* në Statutin e Shkodrës, mbasi është e qartë se si emër etnik në Shkodër ndryshe nga Venediku nuk kishte se si të emëronte një shtresë të skllavëruar, mbasi përkundrazi, në Shkodër sllavët ishin zotër të qytetit në kohën kur u hartuan Statutet. Kështu në këtë Statut, përdoret vetëm emërtimi *servus* dhe *ancilla*, pavarësisht se a bëhej fjalë për skllavë «*proprie dicti*» apo për shërbëtorë.<sup>11</sup> Përveç këtyre me rëndësi është edhe dallimi mes skllavërisë

<sup>8</sup> Aristotle, *Politics*, in Aristotle in 23 Volumes, vol. 21, translated by H. Rackham. Cambridge, MA, Harvard University Press, 1944. 1253b 32, «and property generally is a collection of tools, and a slave is a live article of property».

<sup>9</sup> Charles Verlinden, “L’origine de sclavus=esclavage”, *Archivium Latinitatis Medii Aevi*, t. XVII, 1942, f. 125.

<sup>10</sup> “*Le coste orientali del Mar Adriatico sono quelle che hanno alimentato piu considerevolmente la classe schiava del mondo mediterraneo nel basso Medioevo*”. Charles Verlinden, “Le relazioni economiche fra le due sponde adriatiche nel basso medioevo alla luce della tratta degli schiavi”, në *Momenti e problemi della storia delle due sponde adriatiche: Atti del I° Congresso internazionale sulle relazioni fra le due Sponde adriatiche* (Brindisi, Lecce, Taranto, 15-18 ottobre 1971), ed. Pier Fausto Palumbo, Le Edizioni del Lavoro, Roma: f. 24.

<sup>11</sup> *Statutet e Shkodrës në gjysmën e parë të shekullit XIV me shtesat deri më 1469 / Statuti di Scutari della prima metà del secolo XIV con le addizioni fino al 1469*, shqipëroi Pëllumb Xhufi, Vjollca Lisi, Tiranë: Onufri, 2010, kap. 2, 71, 202, 220, 221. Për të njëjtën arsye duket që kjo fjalë nuk përdoret as në dokumentet dalmate me të njëjtin kuptim si në ato italiane. Sipas A. Teja, dokumentet dalmate bëjnë një dallim të

dhe rrogëtarisë apo shërbëtarisë. Në veprat e shumë autorëve skllavi është identifikuar apo është ngatërruar me shërbyesin apo rrogëtarin.<sup>12</sup> Megjithatë duhet theksuar se skllavëria mesjetare në përgjithësi kufizohej në shërbëtorë shtëpiakë dhe nuk përbënte më fuqinë kryesore punëtore në ekonomi siç ndodhte në botën antike.<sup>13</sup> Gjithsesi, statusi ligjor i këtyre shërbëtorëve nuk mund të përfytyrohet si thelbësisht i ndryshëm nga ai i skllavërisë.<sup>14</sup> Simbas Susan Mosher Stuard, terminologjia e ndryshme e përdorur për të përshkruar shërbëtorët shtëpiakë në Raguzë gjatë Mesjetës të tillë si *famuli, famulae, homines, servientes, pueri, puellae, ancillae* e errësojnë më tepër se sa e qartësojnë statusin ligjor të tyre.<sup>15</sup>

Fillimisht kontingjenti i skllavëve në Europë ka qenë mbushur vetëm me jo të krishterë. Këtu përfshiheshin sllavët paganë në lindje të Gjermanisë, myslimanët si dhe popullsitë pagane të bregut verior të Detit të Zi. Shek. XI në Sicili ashtu si edhe në Spanjën myslimane që një periudhë përshtjellimi e përçarjesh. Kjo çon në Sicili në pushtimin norman dhe struktura e skllavërisë në Italinë e Jugut ndryshon. Tashmë zona e furnizimit me skllavër që kufizohej në shek. XIII me Spanjën myslimane e Afrikën e Veriut do kalojë të jetë në shek. XIV ajo e Mesdheut Lindor, e Ballkanit dhe e Detit të Zi.<sup>16</sup> Në përgjithësi Papatë në përputhje me rrethanat është përpjekur të kufizojë skllavërimin e ortodoksëve grekë.

qartë mes termit *sclavus* dhe *servus*, në kuptimin që vetëm ky i fundit tregon një konditë skllavërie. Antonio Teja, "Aspetti della vita economica di Zara dal 1289 al 1409", *Rivista Dalmatica*, II, Zara: 1941-1942, f. 23-24.

<sup>12</sup> Një pasqyrim të zgjeruar të veprave në të cilat këto dy institucione janë identifikuar me njëri-tjetrin, veçanërisht në trajtesat e periudhës së Antikitetit të Vonë dhe të Mesjetës, mund të shihen tek Charles Verlinden, *L'esclavage dans l'Europe medievale*, De Tempel, Brugge, t. I, 1955, f. 9-12.

<sup>13</sup> Jacques Heers, *Esclaves et domestiques au Moyen Age dans le monde méditerranéen*, Paris: Fayard, f. 15; Charles Verlinden, "Venezia e il commercio degli schiavi provenienti dalle coste orientali del Mediterraneo", in *Venezia e il Levante fino al secolo XV*, vol. I, ed. Agostino Pertusi. Firenze: Leo S. Olschki Editore, 1973, f. 927; Susan Mosher Stuard, "Ancillary evidence for the decline of Medieval slavery", *Past and present*, 149, 1995, f. 4.

<sup>14</sup> Sipas Marc Bloch, megjithëse skllavëria u zhduk në Perëndim gjatë Mesjetës, gjithsesi një bërthamë e fortë e saj vazhdoi të jetë e pranishme edhe në këtë periudhë. Marc Bloch, "Personal liberty and servitude", in *Slavery and serfdom in the Middle Ages. From slavery to feudalism in South- Western Europe*, ed. Pierre Bonnassie. Cambridge: Cambridge University Press, 1991, f. 33-92.

<sup>15</sup> Susan Mosher Stuard, "Urban domestic slavery in Medieval Ragusa", *Journal of Medieval History*, 9, 1983, f. 162.

<sup>16</sup> Ch. Verlinden, *L'esclavage dans l'Europe medievale...*, f. 155.

Kështu papa Urbani V, i cili ishte një mbështetës i zjarrtë i afrimit me kishën e Konstantinopojës më 1369 bën thirrje që të lirohen të gjithë ortodoksët e ritit grek mbas shtatë vitesh skllavërie<sup>17</sup>.

Fenomeni i skllavërisë përveçse është pasqyruar në traditën gojore të popullit shqiptar, ka edhe dokumentimin e vet në legjislacionin e kohës. Shembulli më tipik për të kuptuar se sa i përhapur ishte ky fenomen në zonën e Shkodrës është Statuti i këtij qyteti, i cili mendohet se është hartuar në pjesën e parë të shek. XIV, atëherë kur fenomeni i skllavërisë në brigjet e Adriatikut Lindor po merrte zhvillimin e tij më të plotë. Që në nenin e parë të këtij Statuti del plotësisht e qartë atmosfera e kohës dhe që në fakt përputhet edhe me të dhënat e zonave të tjera. Kështu në nenin e parë thuhet: “Nëse ndokush do të dëshironte të qëndronte në qytetin tonë... Në rast se ndonjëri nga qytetarët tanë, apo Sllav a Arbëresh, do të përpiqej ta bënte pronë të vetën, do t’i paguajë Mbretit 50 hyperperë”.<sup>18</sup>

Të njëjtën situatë përshkruan edhe neni 262, prej të cilit krijohet ideja se skllavërimi i njerëzve në Shkodër kishte marrë përmasa të tilla sa që kushdo që nuk ishte nga qyteti, ishte i pambrojtur nga mundësia që të robërohej prej banorëve të tij. Madje, duket se vetë nëpunësit e administratës dhe gjykatësit përfitonin nga kjo gjendje pasigurie. Në këtë nen thuhet: “I huaji që vjen nga jashtë... askush nuk mund ta përvetësojë si njeriun e vet”.<sup>19</sup> Mbi atë se si ka qenë kjo skllavëri, në se ka qenë skllavëri e mirëfilltë apo jo, del e qartë edhe në nenin e dytë, ku vrasja e skllavit dhe skllaves (shërbyesi dhe shërbyeses), i bashkangjitet vrasjes së kalit.<sup>20</sup> Gjithashtu edhe në nenin 202 del se kjo skllavëri mund të ishte e trashëgueshme, domethënë djali apo vajza e skllaves do të ishte skllav apo skllave e të njëjtit pronar. “Nëse dikush përdhunon skllaven e një burri a të një gruaje dhe nëse skllavja vdes gjatë lindjes, përdhunuesi detyrohet t’i japë padronit të skllaves një tjetër skllave. Djali ose vajza e lindur prej skllaves, do të jetë skllave ose skllavi i padronit në fjalë.”<sup>21</sup> Në fakt në këtë nen nuk thuhet asgjë mbi ndonjë dënim të mundshëm të

<sup>17</sup> J. Heers, *Esclaves et domestiques...*, f. 78.

<sup>18</sup> “*Et se alcun de li nostri citadini, voy sclavo vou albanese, vulissi lupir voy apropiar a sé, che paghi perperi L a lo re*”. *Statuti di Scutari...*, f. 207 (299).

<sup>19</sup> *Po aty*, f. 278 (373).

<sup>20</sup> “*de servo et de ancilla, de cavallo et de questi cosi...*”. *Po aty*, f. 207 (299).

<sup>21</sup> “*chi la sforzasse sia tenuto de dar a lo parone de la ancilla una altra ancilla*”. *Po aty*, f. 264 (358).

atij që e përdhunon skllaven e dikujt tjetër, por thjesht trajton vetëm dëmshpërblimin e pronarit në rast të humbjes së skllaves gjatë lindjes. Mbi atë se termi “ancilla” tregon një grua që ka një status shoqëror më të ulët se sa të gjitha shtresat e femrave, madje edhe se prostituta, dëshmon edhe fakti se përdhunimi i grave të lira, jepet në një nen të veçantë, në nenin 201.<sup>22</sup>

Nëse në Pizë sipas dispozitave të vitit 1376, babait të fëmijës i jepej e drejta që brenda 15 ditëve ta blinte fëmijën kundrejt çmimit prej 10 florinësh, dhe mbas 15 ditëve e kishte sërish të drejtën për ta marrë fëmijën e vet, por në këtë rast çmimi vendosej mes pronarit dhe të atit të fëmijës,<sup>23</sup> në Shkodër nuk i jepet asnjë mundësi të atit për ta pasur fëmijën e vet, por i mbetet automatikisht pronarit. Në Statutin e Shkodrës jo vetëm që skllavi nuk kishte të drejtë të largohej nga shtëpia e pronarit, por edhe ata të cilët e nxisnin skllavin për të ikur, thjesht duke e këshilluar, dënohej me gjobë.<sup>24</sup> Aq më tepër që në nenin pasues 222 thuhet qartë se shërbëtori nuk ishte njeri i lirë dhe kishte një dallim të qartë mes tyre.<sup>25</sup>

### Venediku

Prania e shqiptarëve në Venedik shkon duke u bërë gjithnjë e më e ndjeshme duke filluar sidomos që prej gjysmës së dytë të shek. XIV, pikërisht atëherë kur Venedikut i ikën nga duart Dalmacia që për më tepër përkon me pasojat e rënda të krizës demografike pas murtajës së viteve 1348-1350.<sup>26</sup> Megjithatë, edhe pse më 1358 bëhet një kalim «sovrانيتeti» i Dalmacisë tek hungarezët, të cilët pretendonin trashëgiminë anzhvine në bregdetin dalmato-shqiptar, më pas duke filluar nga vitet 1420, Venediku ia del të rivendosë ndikimin e vet në Dalmaci. Një pjesë e këtyre shqiptarëve shkojnë në Venedik për të kërkuar punë

<sup>22</sup> *Po aty*, f. 264 (358).

<sup>23</sup> Ch. Verlinden, *L'esclavage dans l'Europe medievale...*, f. 715.

<sup>24</sup> Neni 221: "zaschaduna persona chi straponisse cervo over ancilla over fioli de li dicti e concilio li desse a fuger del suo parone e provar si podesse, chi paghi per pena perperi VIII". *Statuti di Scutari...*, f. 269 (363).

<sup>25</sup> Neni 222: "De furto servo cum libero". *Po aty*, f. 269 (363-364).

<sup>26</sup> Periudha nga viti 1350 deri më 1450 përbën edhe periudhën në të cilën dukuria e skllavërisë merr përmasat më të gjera në krejt historinë e Republikës së Venedikut. Pompeo Molmenti, *Venice its Individual Growth from the Earliest Beginnings to the Fall of the Republic. The Middle Ages*, Part I, f. 124-126.

me dëshirën e tyre edhe pse mbas mbërritjes shpesh binin në statusin e skllavit ose të shërbëtorëve. Mirëpo, ka mjaft prej tyre që ishin blerë si skllavër që në tokat shqiptare dhe natyrisht që ishin në dijeni të statusit të skllavërisë që do të kishin në Venedik.<sup>27</sup>

Një tekst interesant na jep hollësi mbi këtë trafik.<sup>28</sup> Më 22 maj 1391, Senati venedikas shqyrtonte një kërkesë të bërë më parë ndaj sundimtarit të Pesaros në të cilën i kërkonte atij një dëmshpërblim prej 250 dukatësh për “Anthonius de Dulcigno, subditus noster” i cili tre vjet më parë kur transportonte 100 shqiptarë nga Durrësi për në Venedik, gjatë një ndalese në Pesaro, ushtarët e sundimtarit i kishin zbritur shqiptarët nga anija dhe fatkeqi Anton ishte detyruar të nisej pa asnjë shqiptar. Nga ky dokument mësojmë se bëhet fjalë për persona jo të lirë mbasi këtë e dëshmon zbritja e tyre e detyruar në Pesaro, sikur të ishin mall për shitje.<sup>29</sup> Nuk përjashtohet mundësia që të kemi të bëjmë me rekrutë ose rremëtarë.

Edhe mbas pushtimit të bregdetit verior shqiptar nga Venediku, kjo dukuri vazhdon të dëshmohet në dokumentacionin e kohës. Kështu, më 19 qershor 1421, Alexius de Tarvisio, banor i Venecias, i shet një vejushe veneciane një shqiptare 19 vjeçe. Shitësi rezervonte të drejtën për ta riblerë skllaven në krye të 15 vjetëve me të njëjtin çmim. Një klauzolë e ngjashme del edhe në një akt të 6 korrikut 1428, ku Bortalano Nicholai i shet Troilo Superancios një skllave “de genere Albanensium”, e quajtur Filipa, 22 vjeçe. Mbas gjashtë vitesh e gjysmë ajo duhej të lirohej.<sup>30</sup>

Këto klauzola të lirimt padyshim që duhet të kenë lidhje me dispozitat e Consiglio dei Pregadi të 1387 dhe 1388 të cilat bëjnë fjalë për ferishtet (anime, pra, fëmijë nën moshën e pjekurisë) e importuara

<sup>27</sup> “From the middle of the fourteenth century Albanians had been taken in fairly large numbers and sold as slaves in Italy”. John V. A. Fine, *The Late Medieval Balkans: A Critical Survey from the Late Twelfth Century to the Ottoman Conquest*, University of Michigan Press, 1994, f. 511.

<sup>28</sup> *Archivio di Stato di Venezia* (më tej: ASV) *Senato Misti*, XI, 1, fl. 138v; *Acta Albaniae Veneta*, vol. II, nr. 469, f. 116-117.

<sup>29</sup> Alain Ducellier, “Les albanais a Venise aux XIV<sup>e</sup> et X<sup>ve</sup> siecles”, në *Travaux et Memoires* 2, Paris: 1967, f. 408, ku pohon në lidhje me këtë se “*les conditions de traversée ne devaient donc être guère différents de celles qui mposaient les negriers du XVIIIe siècle*”.

<sup>30</sup> ASV, Notai della Cancelleria inferiore. Notaio Alberto Cecchini; notaio Ambrogio de St. Vidal (Regjistri i noterit Alb. Cecchini dhe Regjistri i noterit Ambr. de St. Vidal); Ch. Verlinden, *L’esclavage dans l’Europe medievale...*, f. 657.

nga prapatoka e Durrësit dhe për të cilët u kërkua që skllavërimi i tyre të kufizohej në 10 vjet. Nëpërmjet një akti të vitit 1448, mësojmë se, një tregtar venecian, kishte blerë për llogari të Paolos nga Treviso një shqiptarë të quajtur Eudoksi, vetëm 13 vjeçe me një çmim prej 32 dukatësh.<sup>31</sup> Gjatë shek. XIV shumë skllavër shqiptarë të Epirit (Despotatit) patën qenë shitur mjaft shpesh në Kretë,<sup>32</sup> mirëpo skllavërit shqiptarë që hasen në Venedik në shek. XV zakonisht vijnë nga territoret e Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut. Në një dokument të 13 majit 1388 del një grua e quajtur Menega de Durazzo, shërbëtore e një zonje venedikase.<sup>33</sup>

Skllavëria në zonat e kolonizimit venedikas merrte karakteristika të veçanta nga ajo e metropolit. Që me shkatërrimin e Perandorisë Bizantine më 1204, venedikasit dhe gjenovezët krijuan një situatë koloniale nëpërmjet zotërimit të pikave strategjike të tregtisë në Lindje. Bregu lindor i Adriatikut është zona më e afërt e qyteteve të mëdha italiane në mesin e territoreve lindore në të cilat do të krijohet një areal supremacie e një tipi qartësisht kolonial, në të cilën resurset ekonomike shfrytëzoheshin në favor të fuqisë përfituese prej situatës koloniale. Mes këtyre resurseve një vend të rëndësishëm merr krahu i punës, ku shfrytëzimi i kësaj fuqie punëtore do të bëhet me tiparet e skllavërisë. “Afrika e parë” e këtij kolonizimi siç e quan Ch. Verlinden, ka qenë bregu dalmat dhe ai shqiptar.<sup>34</sup> Rreth kushteve të skllavërisë dhe statusit të skllavëve në Venedik ka pasur kontribute nga autorë të ndryshëm të cilët i dokumentojnë dispozitat e para që hedhin dritë mbi kushtet dhe mënyrën e trajtimit të skllavëve vetëm në shek. XIII.<sup>35</sup>

<sup>31</sup> Blerësi mundej «*eam habendi, tenendi, possidendi, gaudendi, baratandi, permutandi, dandi, donandi, vendendi, alienandi*». F. Zamboni, *Gli Ezzelini, Dante e gli schiavi*, Roma-Torino: 1906, f. 423.

<sup>32</sup> Ch. Verlinden, *L'esclavage dans l'Europe medievale...*, f. 834 (viti 1329), f. 839, 870 (viti 1381-1383).

<sup>33</sup> ASV, *Avogaria de Comun*, Raspe IV, fl. 114v; A. Ducellier, "Les albanais a Venise...", f. 407.

<sup>34</sup> Ch. Verlinden, *L'esclavage dans l'Europe medievale...*, f. 713.

<sup>35</sup> V. Lazari, "Del traffico e delle condizioni degli schiavi in Venezia nei tempi di mezzo", në *Miscellanea di storia italiana*, t. I, Torino, 1862; A. Valsechi, "Bibliografia analitica della legislazione della repubblica di Venezia. Della Schiavitù", në *Archivio Veneto*, t. 13, 1877, f. 108-119; L. Cibrario, *Della schiavitù e del servaggio*, t. I. Milano: 1868.

Megjithë përpjekjet për ta kufizuar, trafiku i fëmijëve skllavër vazhdoi gjatë gjithë shek. XV. Mbas mesit të shekullit nuk flitet më për ta si një kategori e veçantë skllavërisht dhe kjo shpjegohet me faktin se tashmë ata shkojnë duke u shndërruar dhe rënë në të njëjtin status me skllavërit e përjetshëm.<sup>36</sup> Përsa u përket femrave përveç pranisë së tyre në Venedik si shërbëtore shtëpiake ose skllave ka raste kur përmenden edhe si të shfrytëzuara si prostitutat, siç është rasti i një shqiptareje të quajtur Anjeza, që del në një dokument të 16 shtatorit 1401.<sup>37</sup>

Një sërë masash të aprovuara në vitet 1386, 1387 dhe 1388 kishin të bënin me fëmijët skllavër të quajtur *anime*.<sup>38</sup> Skllavërimi i tyre krijonte hapësirë për shumë abuzime, gjë që ishte në kundërshtim me ligjet hyjnore dhe me nderin e Republikës. Shumica e këtyre fëmijëve vinin nga territoret shqiptare (de partibus Duracii) si dhe nga zona të tjera bregdetare të Adriatikut. Ch. Verlinden e krahason situatën e fëmijëve shqiptarë të skllavëruar në Venedik me atë të fëmijëve dhe të rinjve që shfrytëzoheshin në shekujt e mëvonshëm në kolonitë angleze e franceze të Amerikës.<sup>39</sup> Madje, mund të qeheshin ndryshe edhe pararendësit e tyre.<sup>40</sup> Masat e ndërmarra nga pushteti venedikas për kufizimin e këtij fenomeni ishin në kundërshtim me interesat e drejtpërdrejta ekonomike të grupeve të caktuara. Nga arsyetimet e paraqitura del se pronarët e tyre e quanin të padrejtë që shfrytëzimi i ferishteve të ishte vetëm katër vjet,

<sup>36</sup> Ch. Verlinden, *L'esclavage dans l'Europe medievale...*, f. 719.

<sup>37</sup> ASV, *Avogaria de Comun*, RaspeV, fl. 142. "Agnes de Albania"; A. Ducellier, "Les albanais a Venise...", f. 409.

<sup>38</sup> "multe anime de istis que conducte fuerunt Venetias et conducentur de cetero de partibus Duracii et de aliis partibus deinde tam de intra quam de extra Culphum que leviter vendite sunt et vendi possent et tractari pro sclavis, quod esset pessime factum et contra Deum et honorem nostri domini". ASVV, Consiglio dei Pregadi, Capitolare del magistrato capitum sexteriorum, 22. nëntor 1386, fl. 25. Botuar në Ch. Verlinden, *L'esclavage dans l'Europe medievale...*, t. II, f. 674-676.

<sup>39</sup> Kompania e Virgjinias transportonte në Amerikë njerëz të cilët nuk kishin mundësi të paguanin shpenzimet e udhëtimit dhe kështu nënshkruanin me ta një marrëveshje sipas së cilës kjo kompani kishte të drejtën t'ua shiste të tretëve me qëllim që të arrihej shumica e kërkuar. Shumica e tyre ishin të rinj të varfër që merreshin me forcë nga matrapazë. Charles Verlinden, "Modernità e medioevalismo nell'economia e nella società coloniale Americana", në *Annali dell' Istituto di Storia Economica e Sociale*, nr. 4, Napoli, 1965, f. 55 e në vazhdim.

<sup>40</sup> "Les anime de Venise sont, de toute évidence, des précurseurs des intentured servants et des engagés de l'Amérique coloniale". Ch. Verlinden, *L'esclavage dans l'Europe medievale...*, f. 679-680.

mbasi nuk i mbulonin as shpenzimet e bëra për t'i mbajtur me bukë. Në këtë përpjekje për të mos lejuar zvogëlimin e burimit të të ardhurave, tregtarët dhe pronarët e fëmijëve skllëvër nuk ngurronin të paraqisnin edhe argumentin se skllavëria e këtyre fëmijëve ishte një shpëtim për ta, mbasi vinin nga zona të kërcënuara nga turqit.<sup>41</sup> Ndalimi i eksportimit të fëmijëve jashtë Venedikut kishte të bënte edhe me faktin se në qytetet e tjera situata e tyre rëndohej edhe më tepër. Për këtë arsye më 1459, *Këshilli i Lutësve* ndërmoi masa të rrepta në mënyrë që fëmijët skllëvër të blerë në Istria, Dalmaci e Shqipëri të mos shiteshin në Firence, Sienë dhe Bolonja, mbasi skllavërimi i tyre bëhej i përjetshëm në këto qytete.<sup>42</sup>

Shqiptarët nuk kanë qenë gjithnjë vetëm viktime të skllavërisë, por në ndonjë rast edhe kanë marrë robër apo kanë skllavëruar të tjerët. Mund të përmendim në këtë rast sulmin e kryer nga shqiptarët mbi kështjellat dhe rrethinat e Koronit dhe të Modonit në shkurt të vitit 1418, ku si pretekst duket se ishte sjellja brutale e proveditorit venedikas Bernabo Loredan ndaj shqiptarëve të rrethinave të këtyre kështjellave. Në këtë rast shqiptarët morën me vete një numër të konsiderueshëm robërish.<sup>43</sup>

### Kreta

Në Kretë pjesa më e madhe e skllëvërve shqiptarë vinin nga zona e Epirit (de partibus Despotatus) edhe pse shumica cilësoheshin si grekë, qartësimi që bëhej se ishte prej zonave të Despotatit të Epirit lë të nënkuptohet se kemi të bëjmë me shqiptarë. Kështu, më 1 korrik 1329, një banor i Kanasë i shet një kretasi një shqiptar, të cilin e kishte blerë nga një venedikas, për 20 iperperë dhe një broke verë. Më 1 tetor 1332, Guiljelmus Simon, katalan, banor i Tebës, i shet Johannes Gerardos,

<sup>41</sup> E pohon Ch. Verlinden, *L'esclavage dans l'Europe medievale...*, f. 680, këtë "dose non négligeable d'hypocrisie que contient cet exposé de motifs", por i intereson autorit që të përcaktojë zonën e furnizimit me fëmijë skllëvër që del se shtrihet në «nord du Epire, del'Albanie et du Sud de la Yougoslavie actuelle».

<sup>42</sup> L. Cibrario, *Della schiavitù e del servaggio...*, f. 185. Vendim i 17 gushtit 1459 "nei qual luogi le roman in perpetua servitu". V. Lazari, "Del traffico e delle condizioni degli schiavi in Venezia..." , f. 490.

<sup>43</sup> "Avesemo per nuova dai Retori nostri in questo tempo dele parte da Coron e Modon chomo infiniti Albanexi eser vegnudi a daniziar per fina soto i casteli dele parte de Modon, e robado, molte aneme e menandonde via". Antonio Morosini, *Cronaca Veneta*, Biblioteca Nazionale Marciana, Marc. Ital, VII, f. 127-128; A. Ducellier, "Les albanais dans les colonies venitiennes..." , f. 48.

noter nga Kreta, një skllave “de partibus Despotati”, e sjellë nga Teba, me një çmim 36 iperperë. Në të njëjtën ditë ai shet edhe Nicolas “de Despotatu” për 31 iperperë. Emmanuel po ashtu grek «de Despotatu» për 25. Një prift gjithashtu i blen të njëjtit tregtar skllavin Nicolas “de Despotatu” për 27. Më 19 dhjetor Franciscus de Brubrin, nga Barcelona dhe Bernard de Castigelo nga Perpinjani mbërrijnë nga Teba dhe mes tjerësh shesin edhe një skllave me emrin Marie «de Despotatu», një Marie nga Kosturi për 47 dhe një Marie tjetër gjithashtu nga Epiri për 40 iperperë. Më 24 mars 1333 sërish katalani i Tebës Guillelmus Simon shet mes tjerësh një skllav nga Epiri për 22 iperperë. Po ashtu “Maria de partibus Despotati de loco vocato Episcopato” (Peshkëpi?) për 38 iperperë.<sup>44</sup> Mund të thuhet se katalanët në këtë kohë kishin si zonë gjahu për skllavë Greqinë në veçanti Beotinë, Epirin (Despotatus), Atikën dhe brigjet e gjirit të Patrasit. Një pjesë e viktimave të këtyre fushatave të ndërmarra nga katalanët mbërrinin në shumë porte të Mesdheut deri në Egjipt. Regjistrat noterialë dëshmojnë për aktivitetin shumë intensiv të trafikuesve katalanë në Kretë. Në mesin e kontingjentit të skllavëve të trafikuar nga katalanët në Kretë ka edhe një numër jo shumë të madh sllavësh dhe shqiptarësh, mirëpo edhe këta duket se janë kapur në territoret e Greqisë, ku edhe prania e shqiptarëve po shkonte duke u bërë gjithnjë e më e fortë.

Në regjistrat e noterit kretas Manoli Bresciano për vitet 1381-1383 të studiuar nga I. Sakasov, i cili në fakt ka pasur si qëllim ndriçimin e pranisë së skllavëve bullgarë nga Maqedonia në Kretë, hasim edhe shqiptarë. Në mesin e 222 akteve, 130 kanë të bëjnë me bullgarë, ndërsa pjesa tjetër me grekë, tartarë, shqiptarë, çerkezë, vlllehë dhe rusë. Kështu më 15 prill 1381, një venedikas shet një shqiptarë «de loco vocato Despotato» për 30 dukatë. Tre ditë më pas, më 18 prill po ky noter regjistron shitjen e një shqiptareje të quajtur Kali, “de genere Arbanorum”. Më 13 maj, Constantin Kalotheti nga Negroponti i shet Petrus Barbos nga Kreta një shqiptarë të quajtur Irini, për 50 iperperë. Disa ditë më vonë më 22 maj 1382 Barbo e shet Irininë tek Kosta Kypreo për 60 iperperë. Më 10 korrik, venedikasi Giacomo Nani blen nga Marko Maçamurdi nga Kreta shqiptaren Teodora, për 45 dukatë, e cila ishte shtatzënë. Dy ditë më vonë, më 12 korrik Petro Dono blen nga Nicolai Venier, një shqiptarë të quajtur Irini, për 108 iperperë. Më 9 gusht kretasi

<sup>44</sup> Ch. Verlinden, *L'esclavage dans l'Europe medievale...*, f. 834-837.

Johannes Cavalario i blen katalanit Jacome Gerardo një shqiptar “de loco vocato Situni”, të quajtur Gjergj për 28 dukatë. Tek i njëjti noter, më 18 shtator kretasi Guiljelm de Ferrara i shet një venedikasi një shqiptare për 91 iperperë. Pa kaluar një javë, më 21 shtator Oliesa de Ripa, vejushë nga Kreta i blen një tregtari një shqiptare të quajtur Marie, për 100 iperperë. Më 13 tetor po ky person i shet Johannes Contarinit nga Kreta, një tjetër shqiptare, për 65 iperperë. Të nesërmen, më 14 tetor tek i njëjti noter deklarohet akti i shitjes së një tjetër shqiptareje nga Janina, me emrin Marie, për 90 iperperë. Në këtë rast shitësi është Nicola Maçamano ndërsa blerësi është Johannes Danduli të dy nga Kreta.<sup>45</sup> Më 16 janar 1383, Johannes Cavalarius i shet Georges Moscos, një shqiptar të quajtur Gjergj, për 65 iperperë. Ky shqiptar është ai që Cavalarius e kishte blerë nga katalani Jacome Gerardo më 9 gusht, për 28 dukatë. Pak ditë më vonë, më 27 janar, Petro Bartholomei i shet Urso Justinianit një shqiptare të quajtur Kali, për 100 iperperë. Dy javë më vonë, më 10 shkurt Olyosa de Ripa nga Kreta i shet një greku një shqiptare të quajtur Marie, për 96 iperperë. Është interesant fakti se kjo Maria shqiptare që në këtë rast shitet për 96 iperperë, ishte blerë nga Oliesa më 21 shtator për 100 iperperë. Më 14 shkurt Emmanuel Maçamurdi i shet Stephano Saglichit, shqiptaren të quajtur Kali, për 80 iperperë.<sup>46</sup> Më 14 maj të po këtij viti dhe tek i njëjti noter kryhet shitja e Marizës (Mariça), shqiptare për 100 iperperë. Në këtë rast shitësi është Georges Mudacius dhe blerësi është Petro Gradonico të dy nga Kreta. Katër ditë më vonë, më 18 maj blerësi Petro Gradonico ia shet Marizën për 100 iperperë kretasit tjetër Emmanuel Fecha.<sup>47</sup>

Në total sipas përlllogaritjeve del se vetëm nga analizimi i 452 akteve të noterit të Kretës, Bresciano, shqiptarët zënë rreth 3% të totalit, duke ardhur menjëherë mbas bullgarëve (31 %), grekëve (29%) dhe tartarëve (22%), duke zënë të njëjtën peshë me rusët dhe çerkezët. Nga ana tjetër, ua tejkalojnë serbëve, vllehve (1.4%) dhe turqve (0.7%).<sup>48</sup>

<sup>45</sup> *Po aty*, f. 399-400, 850-856.

<sup>46</sup> *Po aty*, f. 860-861.

<sup>47</sup> Ivan Sakasov, "Documents récemment découverts datant de la fin du XIV<sup>e</sup> siècle et concernant les Bulgares de la Macédoine vendus comme esclaves", *Makedonski Pregled*, t. VII, Sofie: 1932, f. 1-62.

<sup>48</sup> Ch. Verlinden, *L'esclavage dans l'Europe medievale...*, f. 996.

### Italia e Jugut dhe Sicilia

Në një dokument të 6 dhjetorit 1274, mbreti anzhuin i Siçilisë Karli, me synimin për të fituar mbështetjen e shqiptarëve dhe grekëve në tokat shqiptare urdhëronte gjykatësin e Barit, se të gjithë robërit shqiptarë dhe grekë duhet të liroheshin, përndryshe, kundravajtësit do të ndëshkoheshin rëndë.<sup>49</sup>

Më 10 maj 1349, fisniku Nicolas de Lubisio shiste “operas et servicia” të një skllaveje shqiptare të quajtur Milika. Blerësi është një qytetar i Kameratës i quajtur Guillaume de Arcudio. Gjithashtu, më 2 dhjetor 1353, Passatutto de Gambolino de Castronuovo i shet fisnikut Ignazio de Auria “servum suum de genere Albanorum” për 2 onxha. Simbas Ch. Verlinden formula “opera et servicia” e përdorur në rastin e parë dhe që mungon në të dytin na çon në përfundimin se Milika ishte ortodokse, kurse fatkeqi tjetër, jo.<sup>50</sup>

Me fillimin e emigracionit të shqiptarëve drejt Siçilisë nga fundi i shek. XIV mundësia e skllavërimit ishte mjaft e madhe përderisa shumica dërrmuese e atyre që vinin si emigrantë në ishull ishin të varfër dhe punëtorë krahu. Kështu kontrata në të cilën del shqiptari Milanus Kapunigru është dëshmi e këtij fakti. Në dokument thuhet qartë se ky shqiptar (de partibus Albanie) i jepej një noteri nga pronari i tij për katër vjet, për të kryer çdo shërbim (ad omnia servicia).<sup>51</sup>

### Firence

Më 8 mars 1364, një provizion i komunës së Firences lejon importimin e skllavëve prej çfarëdolloj prejardhje e zone me kusht që të mos ishin katolikë,<sup>52</sup> domethënë në këtë leje importimi përfshiheshin edhe ortodoksët. R. Livi duke studiuar këtë regjistër të shitjes së

<sup>49</sup> *Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia*, vëll. I, nr. 334, f. 97. Në lidhje me motivet që e shtynin Karlin që ta bënte një gjë të tillë më gjerësisht shih Deno John Geanakoplos, *Emperor Michael Palaelogus and the West. 1258-1282. A Study in byzantine-latin Relations*, Harvard University Press, Cambridge, Massachusetts: 1959, f. 279-280.

<sup>50</sup> Ch. Verlinden, *L'esclavage dans l'Europe medievale ...*, f. 187-188.

<sup>51</sup> Henri Bresc, “Pour une histoire des Albanais en Sicile. XVe- XVe siècles”, në *Archivio storico per la Sicilia Orientale*, nr. 68, Catania: 1972, f. 531-532. Duket se ky shërbim për katër vjet është i barazvlefshëm me çmimin e lirisë.

<sup>52</sup> G. Mueller, *Documenti sulle relazioni delle città toscane coll'Oriente cristiano e coi Turchi fino all'anno MDXXXI*, Firenze: 1879, f. 120.

skllevërve që janë kryer në Firenze prej 4 korrikut të 1366-ës e deri më 2 mars 1397, në një total të 357 shitjesh njofton se tartarët përbëjnë shumicën, 274 ose 78.7 % të totalit. Grekët 8.6% të totalit të skllevërve të cilëve u përmendet etnia apo feja. Në këtë regjistër ka gjithashtu një shqiptare.<sup>53</sup>

Sklllevërit ballkanikë mbërrinin në Firenze kryesisht përmes Raguzës.<sup>54</sup> Dokumentet e botuara nga M. Dinić dëshmojnë se tregtarët fiorentinë ishin shumë aktivë në këtë tregti në Raguzë,<sup>55</sup> kryesisht në bashkëpunim me tregtarët nga Ankona, të cilët edhe bënë transportin e skllevërve përtej detit. Avancimi i osmanëve në Ballkan do të shndërrohet në një faktor që do të shkojë duke ndikuar gradualisht në këtë trafik. Duket se interesat ekonomike mbizotërojnë ndaj ndjenjave fetare. Kështu nëse një skllav u blihej osmanëve nga tregtarët apo pronarët italianë apo dalmatë, ai mbetej skllav edhe nëse ishte i krishterë.<sup>56</sup> I tillë është rasti i vitit 1421 kur Benedetto di Matteo Schieri nga Prato, i shet fiorentinasit Giorgio di Giorgio Gucci një vajzë 10 vjeçe nga Prishtina e quajtur Milica (*Milliza*), për 10 dukatë, të cilën e kishte blerë nga raguzasi Nikola Glavić. Ky i fundit sipas shitësit fiorentinas e kishte blerë Milicën nga një turk.<sup>57</sup> Përmendja e një zinxhiri kaq të gjatë e të hollësishëm blerjesh dhe që përfundonte gjithmonë tek turqit bëhej në fakt për të fshehur origjinën e vërtetë të skllevërve që shiteshin.

### Gjenova

Sklllevërit ballkanas në Gjenovë ashtu si edhe në Venedik kanë zënë një përqindje të lartë. Këta kryesisht vinin nga zonat e Trakës dhe Detit të Zi. Në mesin e ballkanasve gjatë gjithë shek. XV, skllevërit bullgarë ishin më të shumtit. Mirëpo me rënien e kolonisë gjenoveze të Kafës, nuk janë më bullgarët më të shumtit në mesin e ballkanasve, por boshnjakët dhe në një masë më të vogël shqiptarët, që zënë vendin e parë. 93% e

<sup>53</sup> Ch. Verlinden, *L'esclavage dans l'Europe medievale...*, f. 361.

<sup>54</sup> Paola Pinelli, "L'argento di Ragusa"; *Storia Economica*, Rivista Quadrimestrale, 3 (2005), Edizioni scientifiche italiane, pp. 549-573 ; eadem, *Il Carteggio Marcovaldi (1401-1437) nell'Archivio di Stato di Prato*. Inventario, a cura di Paola Pinelli. Roma, Ministero per i beni culturali e ambientali, 2006. Paola Pinelli, "L'argento di Ragusa".

<sup>55</sup> Mihailo Dinić, *Iz Dubrovačkog arhiva*, Beograd: Naučno delo, 1967, knj. III, f. 34-35, doc. 85, etj.

<sup>56</sup> Ch. Verlinden, *L'esclavage dans l'Europe medievale...*, f. 775.

<sup>57</sup> M. Dinić, *Iz Dubrovačkog arhiva ...*, III, 2 maj 1421, f. 97-98, doc. 208.

ballkanasve janë femra. D. Gioffré ka gjetur pesë shqiptarë të trafikuar ndërmjet viteve 1400 dhe 1450, tre nga 1451 deri më 1475, por ajo çka rezulton domethënëse është se ka identifikuar plot 29 raste për vitet 1475-1500.<sup>58</sup>

Dokumentacioni i shek. XV ka regjistruar një numër gjithnjë e në rritje kërkesash për lirim drejtuar autoriteteve laike e kishtare nga këta skllëvër. Në kërkesat e tyre pothuajse gjithmonë kërkonin të provonin se përpara skllavërimit kishin qenë të krishterë dhe se nuk kishin lindur nga prindër skllëvër por nga prindër të lirë. Kështu më 1443, *Sindikatorët e Gjenovës* marrin në shqyrtim kërkesën e një skllaveje me emrin Sofia, që deklarohet se është shqiptare por qytetare e Raguzës. Në kërkesën e bërë në mbrotje të saj theksohej se robërimi i saj është i padrejtë, mbasi Sofia është shqiptare dhe katolike. Gjykatësit i japin të drejtë kërkesës së Sofies për lirim, mbasi pronari i saj deklaroi se ajo tashmë ia ka shlyer çmimin e blerjes.<sup>59</sup>

### Raguza

Raguza ishte qendra kryesore për kalimin e skllëvërve bogomilë e ortodoksë të brendatokës drejt Italisë.<sup>60</sup> Fenomeni i skllavërisë në bregun dalmat ka qenë një temë që në dallim me rastin e territoreve shqiptare është rrahur dhe studiuar relativisht herët.<sup>61</sup> Në Raguzë pasja në zotërim e një skllavi konsiderohej diçka aq normale sikur pasja e një robe të kushtueshme. Për vetë afërsinë gjeografike marrëdhëniet mes Raguzës dhe territoreve shqiptare zënë një vend të rëndësishëm në gjeografinë e

<sup>58</sup> D. Gioffré, "Il commercio d'importazione genovese alla luce dei registri del dazio (1495-1537)", në *Studi in onore di Amintore Fanfani*, vëll. V, Milano: 1962, f. 48.

<sup>59</sup> J. Heers, *Esclaves et domestiques au Moyen Age...*, f. 80-81.

<sup>60</sup> Bariša Krekić, "Dubrovnik as a pole of attraction and a point of transition for the hinterland population in the late Middle Ages", in *Migrations in Balkan History*, ed. Dimitrije Djordjević. Beograd: SANU, 1989, f. 67-75; Charles Verlinden, "Patarins ou Bogomiles reduits en esclavage", *Studi e materiali di storia delle religioni*, 38, 1967, f. 683-700; Paola Pinelli, "From Dubrovnik (Ragusa) to Florence: Observations on the recruiting of Domestic Servants in the fifteenth Century", *Dubrovnik Annals*, 12, 2008, f. 57-71.

<sup>61</sup> Bibliografia kroate mbi këtë fenomen zë fill që fundin e shekullit XIX, në një punim të kufizuar vetëm me Splitin: G. Alacevich, "Mercato di schiavi a Spalato nel 1540", *Cronaca Dalmatica*, nr. 15, Zara: 1888, ku autori shënon 66 akte shitjeje. Për të vazhduar në vitet 40: Antonio Teja, "Aspetti della vita economica di Zara dal 1289 al 1409", *Rivista Dalmatica*, Zara, 1941-1942.

shkëmbimeve demografike. Që në shek. XIII dokumentohet emigrimi i shqiptarëve në Raguzë. Ky emigracion përbëhej kryesisht nga tregtarë, zejtarë, por në mënyrë të veçantë nga klerikë.<sup>62</sup> Prania e shqiptarëve në Raguzë për vetë afërsinë ishte diçka normale, por po aq normale ishte edhe skllavërimi i shqiptarëve që atje shkonin pa ndonjë pasuri dhe pa letra rekomandimi nga autoritetet prej nga vinin. Në regjistrat noterialë të këtij qyteti ka mjaft akte shitblerjeje skllavëresh shqiptarë, madje që në shek. XIII. Por, përveç fatit të skllavërisë një pjesë shumë e vogël shqiptarësh del si pronar apo si tregtar skllavëresh. Kështu, sipas një akti të 18 majit 1283, një Basil Bonakose nga Durrësi kishte blerë nga njëfarë Muscus Petrarius një skllav të quajtur Simon de Vsora me një çmim prej 8 soldesh.<sup>63</sup> Një rast tjetër është edhe ai i një shqiptari të quajtur Andrea de Spandensia Albanensis, që më 1352 ia shet vajzën e vet Donikën (Dominica) përgjithmonë një argjendari të Raguzës me kushtin e vetëm për ta ushqyer, veshur e mbathur.<sup>64</sup>

Skllavërimi i shqiptarëve që i drejtoheshin Raguzës qoftë për punë qoftë për ndonjë arsye tjetër u bë edhe çështje diskutimi në Këshillin e Rogatëve të Raguzës, ku më 26 korrik 1388 u vendos që të lirohen shqiptarët e ikur e të marrë nga raguzianët<sup>65</sup> dhe u ndalua shitja e shqiptarëve në Raguzë ose në distriktin e saj.<sup>66</sup> Më 1416 autoritetet raguziane ndërmarrin hapin e ndalimit të shitjes së skllavëve me përjashtim të rastit kur ata do të përdroreshin në Raguzë, nisur nga presioni i princërve fqinjë, mirëpo kjo zonë e ndalimit të trafikut shkonte në jug vetëm deri në Mal të Zi (në veri deri në Split), që prej gjirit të Kotorrit deri në atë të Neretvës.<sup>67</sup> Duke qenë se ky ndalim nuk përfshinte

<sup>62</sup> Francis W. Carter, *Dubrovnik (Ragusa). A classic City-state*, Seminar Press, London: 1972, f. 20-21.

<sup>63</sup> G. Čremoćnik, *Istorijski spomenici Dubrovačkog arhiva. Kancelariski e notarski spisi*, Beograd: 1932, nr. 300

<sup>64</sup> Ky shqiptar shet të bijën pa afat “definite usque ad mortem”. M. Dinić, *Iz Dubrovačkog Arhiva...*, III, 26 mars 1352, nr. 22, f. 12.

<sup>65</sup> *Državni Arhiv u Dubrovniku* (më tej: DAD), *Reform. XXVII*, fol. 88; A. Ducellier, *La façade maritime d’Albanie au Moyen Age-Durrazzo et Valona du XI<sup>e</sup> au XV<sup>e</sup> siècle*, Selanik: 1981, f. 545, 627: «*de faciendo libere relaxori omnes Albanenses fugientes captos per nostros Raguseos*».

<sup>66</sup> Jahja Drançolli, “Prania e shqiptarëve në Raguzë gjatë shekujve XIII-XV”, në *Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave historike*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 16-1986, Prishtinë: 1987, f. 57.

<sup>67</sup> *...considerantes talem mercantiam esse turpem, nefariam et abominabilem et contra omnem humanitatem... statuimus et ordinamus quod decetero nullus civis noster... aut*

territoret shqiptare, Raguzë përveç se vend emigrimi për një numër punëtorësh, zejtarësh dhe ushtarësh shqiptarë, vazhdon të jetë edhe mbas këtij ndalimi një vend furnizimi me skllëvër shqiptarë, të cilët tregtarët raguzas edhe i eksportojnë zakonisht drejt Puljes dhe Markave. Aq më tepër që ky hap i Komunës së Raguzës, u zbatua vetëm pjesërisht dhe B. Krekić ka argumentuar se ky ndalim rezultoi të ishte i pjesshëm dhe jo i plotë.<sup>68</sup> Në maj dhe në korrik të vitit 1436 bëhet fjalë për anije raguziane që transportojnë shqiptarë skllëvër në brigjet e Markeve, në Ankona. Jo vetëm nga zonat e veriut por edhe nga zonat jugore siç ndodh me dy skllëvër që tregtarët raguzianë u blejnë himariotëve shqiptarë më 1439.<sup>69</sup>

### Spanja

Në kuadrin e aktivitetit të katalanëve në Mesdhe përfshihet edhe tregtia mjaft e dokumentuar e tyre me skllëvër nga zonat e Greqisë që kishin rënë në dorë të Kompanisë së Madhe Katalane. Si zonë e furnizimit me skllëvër, qoftë përmes blerjes qoftë përmes kapjes shquhet Teba, ndërsa si vend tregtimi del në pah kryesisht roli i Kretës. Kjo tregti arrin kulmin deri në vitet 1330, edhe pse vazhdon edhe më pas deri gjatë shek. XV.<sup>70</sup> Në trevat shqiptare prania katalane gjithashtu ka qenë e ndjeshme, veçanërisht duke filluar nga dekada e dytë e shek. XIV e deri në mesin e shek. XV. Mbretërit aragonezë u përpoqën të ndjekin direktivat e papatit që synonin afrimin me kishën e Konstantinopojës nëpërmjet trajtimit të mirë të skllëvërve grekë ose edhe të lirimt të tyre. Në Barcelonë dhe në të gjitha qytetet e Katalonjës nga fundi i shek. XIV u arrit një marrëveshje e mbështetur nga kisha që parashikonte lirim, menjëherë apo mbas disa vitesh, për të gjithë grekët dhe shqiptarët.

*forensis... audeat vel presumat emere aut vendere servum aut servam vel esse mediator huiusmodi mercantie.* M. Dinić, *Iz Dubrovačkog arhiva*, III, 27 janar 1416, f. 89-90, doc. 200.

<sup>68</sup> Bariša Krekić, "L'abolition de l'esclavage à Dubrovnik (Raguse) au XV<sup>e</sup> siècle-mythe ou realité?", në *Byzantinische Forschungen*, nr. 12, f. 309-317; Bariša Krekić, "Contributo allo studio degli schiavi levantini e balcanici a Venezia (1388- 1398)", in *Studi in memoria di Federico Melis*, vol. II. Napoli: Giannini, 1978, f. 379-394.

<sup>69</sup> DAD, Lamenta de Foris XI fl. 116v, datë 12 maj 1436, ku theksohet se këta skllëvër u ishin blerë shqiptarëve («ab Albanensibus») në Himarë; Alain Ducellier, "L'économie albanaise au Moyen Âge: Une traite coloniale", *Albanie*, nr. 11, Paris: 1981, f. 30.

<sup>70</sup> Ch. Verlinden, *L'esclavage dans l'Europe medievale ...*, I, f. 400-401.

Kjo marrëveshje në fakt qe jetëshkurtër edhe pse u arrit pas një konflikti të gjatë e të ashpër mes autoriteteve fetare dhe përfaqësuesve të borgjezisë qytetase. Në vitin 1396, konflikti mes ipeshkvit të Barcelonës, Ramon de Escales dhe bailiut Sabatista e këshilltarëve bashkiakë arrin pikën kulminante. Ipeshkvi kishte bërë një fushatë të tërë në favor të lirimit të skllëvërve ortodoksë veçanërisht atyre grekë dhe shqiptarë. Përpjekjet e ipeshkvit u kundërshtuan me forcë nga bashkia barcelonase e cila përfaqësonte interesat e klasës së tregtarëve për të cilët puna e skllëvërve si edhe tregtia me ta, ishte shumë e leverdishme.<sup>71</sup> Konflikti zgjati deri më 1403 kur Mbreti Martini I, merr anën e pretendimeve të komunës. Kështu në urdhrin e 8 korrikut 1401, lëshuar me kërkesë të këshillit komunal, u shtua që kërkesat për lirim të skllëvërve grekë, shqiptarë, rusë, bullgarë, vllahë dhe të të gjithë nënshtetasve bizantinë nuk do të merreshin më në shqyrtim, në se nuk shoqërohen me vlerën e kërkuar nga i zoti i skllavit për ta liruuar dhe në se paraprakisht këta skllëvër nuk konvertoheshin në katolicizëm. Konflikti atëherë arrin deri në atë pikë sa bailiu i Barcelonës urdhëron që të nxirret me forcë një skllav që ishte strehuar në pallatin episkopal. Ipeshkvi nga ana e vet, e çkishëron bailiun. Edhe pse asnjëherë autoritetet kishtare nuk e kishin vënë në dyshim legjitimitetin e këtij institucioni, në këtë rast shohim qartas se përpiqeshin të lehtësonin fatkeqësinë e skllëvërve.<sup>72</sup>

Në dokumentet barcelonase krahas skllëvërve shqiptarë katolikë që megjithatë nuk u ishte dhënë liria ka një numër po aq të madh ballkanikësh të tjerë të cilët përmenden si të konvertuar. Natyrisht që konvertimi i tyre duhet të jetë bërë nga feja ortodokse, e cila megjithatë nuk kishte ndonjë trajtim të veçantë madje edhe krahasuar me skllëvërit e origjinës islame. Kështu një vejujë barcelonase i shet më 23 nëntor 1413 një bashkëqytetari të saj një të konvertuar shqiptarë 44 vjeçe për 13 lira.<sup>73</sup> Do bëhet një praktikë e zakonshme robërimi me forcë i të krishterëve ballkanas nga bashkëkombas të tyre të krishterë, dhe të cilët detyroheshin nëpërmjet kërcënimeve që të deklaroheshin si myslimanë. Më 10 qershor 1390 një barcelonas Bernard Simon i blen një raguziani katër skllëvër, të cilët edhe pse cilësohen si të racës tartare, në fakt dy prej tyre ishin bij të krishterësh. Raguziani nga ana e tij i kishte blerë nga

<sup>71</sup> J. Miret y Sans, *La esclavitud...*, f. 24.

<sup>72</sup> Ch. Verlinden, *L'esclavage dans l'Europe medievale ...*, I, f. 464-465.

<sup>73</sup> *Po aty*, f. 457.

një shqiptar që i kishte kapur në Kostur «të Shqipërisë».<sup>74</sup> Po ashtu më 1434 një shqiptar nga Shkodra u shet një turk 22 vjeç, dy katalanëve.<sup>75</sup> Kështu justifikimi se filan skllav i krishterë u ishte blerë turqve shkon duke u bërë një alibi e zakonshme për një praktikë të turpshme të nxitur nga fitimet që paraqiste një tregti e tillë.<sup>76</sup>

Onofre Vaquer Bennàssar, duke studiuar regjistrat e porteve të Maiorkës thekson se deri në mesin e shek. XIV shumica e skllavëve aty ishin arabë, mirëpo nga mesi i shek. XIV, pjesa më e madhe e skllavëve fillojnë të vijnë nga Europa Lindore, kryesisht rusë, tartarë e çerkezë. Një grup tjetër simbas këtij autori ishin skllavërit me origjinë nga Ballkani mes të cilëve përfshiheshin skllavë bullgarë, grekë, shqiptarë dhe serbë. Gjithsesi këta skllavë ballkanikë për periudhën 1448-1499 nuk e kalojnë shifrën 2%.<sup>77</sup> Në regjistrat fiskalë për vitet 1451 gjendet një shqiptarë që i përkiste maiorkinit Jaume Torrella.<sup>78</sup> Në vitin 1458 del gjithashtu një shqiptarë e quajtur Elena, 45 vjeçe të cilën pronari i saj Pere Donadeu ia shiti një të quajtur Ambros Serra.<sup>79</sup>

### Egjipti

Në lidhje me praninë e skllavëve shqiptarë në Egjipt kemi një dëshmi interesante që është një traktat i shkruar nga Emmanuel Piloti më 1420 dhe që përmban të dhëna të vjeshme mbi trafikun që zhvillonte Gjenova me Egjiptin. Sipas dëshmisë së Pilotit gjenovezët por edhe tregtarë të tjerë të krishterë furnizoheshin me skllavë jo vetëm nga kolonitë e tyre të Detit të Zi, por i blinin direkt nga zotërimet osmane, sidomos në Galipoli e Adrianopoli dhe prej aty drejt Egjiptit. Të dhëna të

<sup>74</sup> «qui eos ceperat in Castoria de partibus Albanie». M. Dinić, *Iz Dubrovačkog Arhiva...*, knj. III, nr. 141; Nenad Fejić, "Notes sur le traite des esclaves de Bosnie a Barcelone au Moyen Age (D'apres les documents des Archives de Protocoles", në *Estudis historics i documents dels Arxius de Protocols*, nr. X, Barcelonë: 1982, f. 109-110.

<sup>75</sup> M. Dinić, *Iz Dubrovačkog Arhiva...*, III, 11 nëntor 1434, f. 100, nr. 213.

<sup>76</sup> Ch. Verlinden, *L'esclavage dans l'Europe medievale...*, f. 791, e krahason këtë praktikë me atë të katalanëve që shisnin në shekullin XIII grekë të Kretës duke i detyruar të deklaroheshin si turq të Anadollit.

<sup>77</sup> Onofre Vaquer Bennàssar, *L'esclavitud a Mallorca: 1448-1500*, Mallorc: Institut d'Estudis Baleàrics, 1997, f. 10-12.

<sup>78</sup> Kjo shqiptarë kishte si emër skllavërie Margarita dhe ishte në këtë kohë 50 vjeç. O. Bennàssar, *L'esclavitud a Mallorca...*, f. 15, 32.

<sup>79</sup> *Po aty*, f. 221.

rëndësishme na jep Piloti mbi atë se si vlerësoheshin dhe çmoheshin skllëvërit e etnive të ndryshme në Kajro. Sipas tij, kur skllëvërit mbërrinin në Kajro në oborrin e sulltanit kishte disa persona të specializuar për vlerësimin e tyre, sipas etnive. Më të çmueshmit ishin tartarët, prandaj një tartar vlente zakonisht 130 deri 140 dukatë. Çerkezët vlenin 110 deri në 120 dukatë, grekët 90 dukatë, shqiptarët, boshnjakët dhe serbët nga 70 deri në 80 dukatë.<sup>80</sup>

Mund të përfundojmë, duke theksuar se skllavëria si dukuri shoqërore e kudondodhur në mesjetë, nuk mund të linte paprekur edhe viset e banuara nga shqiptarët. Situata e trazuar në Ballkan dhe në trojet shqiptare, sidomos pas fillimit të shek. XIII dhe rënies së fuqisë bizantine, solli si pasojë kthimin e viseve shqiptare dhe ballkanike në një nga zonat më të lakmueshme për fuqitë të interesuara në tregtimin e fuqisë punëtore të skllavëruar.

### *S u m m a r y*

#### SLAVE TRADE AMONG ALBANIANS DURING THE MIDDLE AGES

Slavery as a social phenomenon that was omnipresent in the Middle Ages, affected strongly also the areas inhabited by Albanians. As a consequence of the troubled situation in the Balkans, especially after the beginning of the 13th century and the collapse of Byzantine power, the Albanian and Balkan lands became one of the most important areas for the powers involved in the slave trade. Although slavery was a common phenomenon and it is increasingly being present in historical studies, it is an issue untreated genuinely by Albanian authors, although the phenomenon of slavery is documented in the legislation of the time. The most typical example to understand how widespread this phenomenon was in the area of Shkodra is the statute of this city, which is thought to have been compiled in the first part of the 14th century, when the phenomenon of slavery on the East Adriatic coast was taking its fullest

<sup>80</sup> *"ung Tartre vaudra cent et trente ou cent quarante ducas, un Charcas vaudra cent et dis ou cent et vint ducas; ung Grec LXXXX ducas, Albanois, Esclavons, Serves de LXX jusques LXXX ducas"*. Emmanuel Piloti, Ed. H. Dopp, *Publications de l'Université Lovanium*, Louvain-Paris: 1958, f. 52.

development. Obviously the most important trading place becomes Venice. The presence of Albanians in Venice becomes increasingly important especially since the second half of the 14<sup>th</sup> century because of the consequences of the demographic crisis after the Black Death. Some of these Albanians went to Venice to seek work, though often after arriving they fell to the status of slaves or servants. However, there are plenty of them that were bought as slaves in the Albanian lands and obviously were aware of their slave status once arriving in Venice. With the beginning of the emigration of Albanians towards Sicily by the end of the 14<sup>th</sup> century, the possibility of enslavement was quite obvious while the overwhelming majority of those who came as immigrants on the island were poor and armed workers. Ragusa was the main center for the passage of Bogomil and orthodox slaves to Italy. Apart from being an attractive emigration place for a number of Albanian workers, craftsmen and soldiers, Ragusa continues to be a supplying market in Albanian slaves well into the 15<sup>th</sup> century especially toward Puglia and the Marche.

In the framework of Catalan activity in the Mediterranean, can also be included their highly documented slave trade from the Greek areas that had fallen into the hands of the Great Catalan Company. As a slave-supplying area, either through purchase or through capture, Teba is distinguished, while the role of Crete is mainly that of a trading place. This trade culminates until the 1330s, though it continues even until the end of the 15<sup>th</sup> century. In the Albanian lands, the Catalan presence has also been important, especially from the second decade of the 14<sup>th</sup> century to the middle of the 15<sup>th</sup> century.

